

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ OWEN TAXI ” SHPK
KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia

Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 28.08.2025, ne, Ortaket e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, me emrin **“ OWEN TAXI ” SHPK**, formulojmë statutin e saj, si më poshtë vijon në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”:

Ortaket e Shoqërisë janë:

Genti Imeri i datëlindjes 01.10.1993, lindur në Pac dhe banues në Durrës, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, me numër identifikimi J31001121B

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Sherbim taksi për publikun si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Blerja, shitja, tregtimi, marrja dhe dhënia me qira, i automjeteve, kullave të karikimit dhe mjeteve të transportit në përgjithësi. Transporti urban dhe interurban në funksion të shërbimit Taxi të udhëtarëve, në përputhje me çdo ligj të zbatueshëm dhe rregulloreve të fushës perkatese.

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marre pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Durrës, Lagjia 5, Rruga” Mujo Ulqinaku ”, Pallati Nr.793.

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Kreu II

Kapitali i regjistruar

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Kapitali i shoqërisë është 10.000 lekë, i ndarë në 1 kuote. Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Genti Imeri është zotërues i 1 kuote, me vlerë 10.000 lekë, me 100 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.

Neni 6: Pagesa e kuotave

Administratorët mund t'i kërkojnë ortakëve pagimin e kontributeve në para të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre.

Në rast të mos shlyerjes së kontributeve, sipas përcaktimit të administratorit, personi përgjegjës do të paguajë një kamatë vonesë mbi shumën e papaguar me interes prej 4% në vit.

Neni 7: Kalimi i kuotave

Kalimi i kuotave dhe i të drejtave që rrjedhin prej tyre, mund të bëhet me kontratë shitblerje, me dhurim, me trashëgimi ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 8: Zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar të votave.

Kreu III

Asambleja e përgjithshme

Neni 9: Të drejtat dhe detyrimet

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) ndryshimet e statutit,
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar,
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj adminsitatorëve,
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë,
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- a) Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori të paktën 2 herë në vit, për të miratuar përkatësisht bilancin vjetor të mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.
- b) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një shkrese dërguar çdo ortaku me postë të zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.
- c) Ortakët, që zotërojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar kanë të drejtë të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet administratorit ose edhe pa ndërmjetësimin e tij.

Neni 11: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- a) Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 50% të aksioneve, për të vendosur për çështje të zakonshme. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga shumica e votave të ortakëve pjesmarrës, (e cilësuar në këtë statut si “shumicë e thjeshtë”).
- b) Mbledhja e Asamblesë, për të vendosur për çështje të veçanta si: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 75% të kuotave. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se tre të katërtat e votave të ortakëve pjesmarrës, (e cilësuar në këtë statut si “shumicë e kualifikuar”).
- c) Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga administratori nëse është e thirrur prej tij. Nëse Asambleja e Përgjithshme është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesohet nga njëri nga ortakët e zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje.
- d) Administratori pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marri fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12: Votat e Pjesëmarrësve

- a) Çdo ortak ka të drejta vote në proporcion me vlerën nominale të kuotes së tij.
- b) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me kuotat, që ai disponon.

Neni 13: Emërimi i Administratorit

- a) Administrimi si dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohen një administratori të vetëm që mund edhe të mos jetë ortak.
- b) Asambleja e Përgjithshme zgjedh fillimisht, **për një periudhë 5 vjeçare një Administrator, Z. Genti Imeri i datëlindjes 01.10.1993, lindur në Pac dhe**

banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi J31001121B me të drejtë riemërimi.

- c) Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin nga detyra, me shumicë të zakonshme votash, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave

Neni 14: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme,
- b. të përfaqësojë shoqërinë,
- c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- d. të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor parashikues për vitin e ardhshëm, për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, brenda dates 20 tetor të vitit paraardhës.
- e. të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor të mbyllur, për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, brenda dates 20 mars të vitit të ardhshëm dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim,
- f. të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- g. të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë,
- h. të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
- i. të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe statut.

Neni 15: Mbledhjet e Administratorit

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë proces verbalet e të gjitha takimeve të kryera nga ai, si dhe të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

Kreu VI

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Neni 16: Shpërndarja e fitimit vjetor

- a) Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.
- b) Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.
- c) Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

Kreu VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 17: Prishja dhe likuidimi

- a) Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.
- b) Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Neni 18: Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

Neni 19: Përfundimi i likuidimit

- a) Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë
- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Neni 20: Dispozitat e fundit

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij statuti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Ortaku i Shoqërisë

Genti Imeri

